



EDUKIMI MJEDISOR



Mars 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

“Edukimi është një zjarrë shndritës, jo një enë që mbushet”

Aristoteli

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujorë Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit mars 2024. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **1 120**

Specialistë të angazhuar **24**

Orë mjedisore të realizuara **56**

56 Shkolla të përfshira

56 Mësues të përfshirë



“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



05 mars 2024, Dita Botërore e efijencës energjiti

Në kuadër të sensibilizimit të kësaj dite, punonjës të AdZM-së Kukës dhe nxënësit e klasës së 10-të, shkolla "Asim Vokshi" Bajram Curri kanë zhvilluar një bisedë për kursimin e energjisë, harxhimin e saj nga pajisje të ndryshme si në shkollë ashtu edhe jashtë saj. Mesazhi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i nxënësve për të zvogëluar sasinë e energjisë së harxhuar në jetën e përditshme dhe për ta kursyer atë kur është e mundur.

12 mars 2024, Dita Botërore mbill një lule

Në ditën e dedikuar mbjelljes së luleve, me nxënës të klasave të 10-11-ta, me prindër dhe mësues krijuam një kënd me lule shumëngjyrëshe në oborin e shkollës. Si vazo për lulet dhe farat e mbjella u përdorën goma makine, të cilat u lye me ngjyra të ndryshme. Përmes kësaj dite të rinjtë jo vetëm zbukuruan shkollën e tyre, por njëkohësisht përdorën sende, të cilat ende nuk e kanë përfunduar ciklin e tyre të jetës.

15 mars 2024, pyjet, biodiversiteti dhe roli mbrojtës

Në vijimësi të edukimit mjedisor, pranë shkollës së mesme "Bushtricë", me klasat 10-11-të zhvilluam një orë mjedisor, kushtuar pyjeve dhe biodiversitetit të pasur që ato kanë. Pyjet, ndryshe mushkëria jonë e gjelbër ndihmojnë dhe ruajnë shëndetin, por njëkohësisht shërbejnë si "shtyllë mbrojtëse" kundër erozionit. Për të përmirësuar gjelbërimin pranë shkollës së mesme "Bushtricë" bashkë me nxënësit mbollëm 100 fidanë, lloji pishë e zezë.

21 mars 2024, pyjet në Alpet shqiptare

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, inxhinierë të këtij sektori janë takuar me nxënës të shkollës 9-vjeçare "Dragobi", përkatësisht me klasën 8-të dhe 9-të. Përmes takimit përçuam tek nxënësit rëndësinë që kanë pyjet dhe roli i tyre jetësorë në zvogëlimin e varfërisë dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

kursimi i energjisë

cikli i jetës

mushkëri e gjelbër

pishë e zezë

mjedis i qëndrueshëm



“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



3 mars 2024, Dita Botërore e jetës së egër

Ora mjedisore e zhvilluar së bashku me klasën e IV-ët të shkollës së Mesme të Bashkuar "Ishull" kishte në fokus njohjen me simbolikën e kësaj dite të rëndësishme. Fillimisht fëmijëve iu prezantua një material njohës me speciet e faunës në zonat e mbrojtura. Më pas nxënësit punuan në mënyrë individuale me lapsa dhe ngjyra, duke realizuar vizatime të kafshëve të egra.

5 mars 2024, Dita Botërore e efijencës energjitike

Specialistët e AdZM-së Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kakarriq" zhvilluan një orë mjedisore në lidhje me efijencën energjitike. Me anë të diskutimeve këshilluam për më shumë ndërgjegjësim dhe sensibilizim mbi nevojën e përdorimit të burimeve energjitike të rinovueshme dhe në mënyrë më të përgjegjshme. Në përfundim me fëmijët u organizua një pyetësor me anë të të cilit kuptuam se sa i qartë ishte mesazhi i përcjellë tek ata.

12 mars 2024, “Mbill një lule”

Në kuadër të ditës “Mbill një lule” stafi AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës së mesme “Ishull – Lezhë” mbollën disa lule dekoruese shumëngjyrëshe, për t'i shtuar më shumë dekor mjedisit. Kjo ditë i kushtohet mbjelljes së luleve dhe ardhjes së sezonit të pranverës dhe fillimin e një sezoni të ri vjetor.

18 mars 2024, Dita Botërore e riciklimit

Në kuadër të Dtës Botërore të ricikimit specialistët e AdZM-së Lezhë së bashku me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Kakarriq" zhvilluan një aktivitet mjedisore në kuadër të kësaj dite. Nën udhëheqjen e specialistëve të AdZM-së, fëmijët arritën të përgatisin objekte, duke përdorur gota, shishe, karton etj. Me anë të ripërdorimit të letrës, plastikës apo qelqit fëmijët krijuan shtëpi kartoni, vazo të ndryshme, maska, kartolina etj, duke kuptuar rëndësinë e procesit të përdorimit dhe riciklimit, duke ulur sasinë e mbetjeve dhe mbajtjes pastër të mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



3 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër luan një rol shumë të rëndësishëm në zinxhirin ushqimor, pasi ai tregon sesi kafshë të ndryshme ushqehen, jetojnë e veprojnë me njëra-tjetrën. Për të njohur nxënësit me botën e pasur të jetës së egër, zhvilluam një orë mjedisore, me klasën e 7-të, pranë shkollës 9-vjeçare “Poçest”. Duke përdorur materiale si: bidon plastik, shkopinjë druri, spango, gërshtë dhe enë plastike, krijuam së bashku shtëpiza ushqimi për zogjtë e malit. Kujdesi për jetën e egër jo vetëm na lidh edhe më shumë me natyrën, por na kujton se gjithësecili mund të kontribuojë pozitivisht në ruajtjen dhe përmirësimin e zinxhirit ushqimor.

12 mars 2024, “Mbill një lule”

Mbjellja e një luleje në ditët e para të muajt mars simbolizon fillimin e stinës së pranverës. Tashmë mbjelljet e tyre nga të rinjtë e të moshuar është kthyer në traditë edhe për vendin tonë. Me rastin e kësaj dite specialistët e AdZM-së Dibër në bashkëpunim me nxënësit e shkollës “Idriz Kaba” mbollën disa lule me fidanë dhe fara, duke përdorur mjetet dhe udhëzimet e nevojshme për një mbjellje efikase. Specialistët tanë iu treguan nxënësve se pas mbjelljes, një fazë tjetër shumë e rëndësishme për jetëgjatësinë e luleve është edhe kujdesi i veçantë para dhe pas ciklit të lulëzimit. Lulet e mbjella dhe ato që mbijnë e rriten në mënyrë natyrore janë një vlerë e shtuar jo vetëm për mjediset natyrore të zonave të mbrojtura, por edhe për mjediset ku ne jetojmë dhe punojmë.

zinxhir ushqimor

fara lulesh

biodiversitet

mjedise natyrore

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



4 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Nxënësit e klasës së parë të shkollës 9-vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi" në Krujë, janë njohur me faunën e Parkut Natyror "Qafështamë" nëpërmjet një ore mjedisore nga specialistët e AdZM-së Durrës. Nxënësit janë informuar mbi llojet e kafshëve të egra, nga se rrezikohen dhe pse ne duhet t'i mbrojmë ato dhe habitatet ku jetojnë. Nxënësit ishin shumë të entuziazmuar, pasi shumica prej tyre e kishin vizituar parkun. Përgjatë bisedës ata përshkruan florën dhe faunën që patën hasur gjatë shetitjes në park, madje sipas perceptimeve dhe ndjesive të tyre vizatuan edhe kafshën e preferuar. Nëpërmjet kësaj ore mjedisore përcollëm mesazhin: toka është shtëpia e specieve të panumërta, por gati një e katërta e të gjitha llojeve në botë janë në rrezik zhdukjeje në dekadat e ardhshme, duke vënë në rrezik edhe njerëzimin; prandaj duke u kujdesur për to ne kujdesemi për jetën e të gjitha gjallesave në tokë.

12 mars 2024, "Mbill një lulë"

Dita "Mbill një lule" i kushtohet mbjelljes së luleve dhe ardhjes së pranverës, ndaj këtë herë ishim me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare "Myrteza Hamit Pengili" për të realizuar mbjelljen e luleve së bashku me nxënësit. Kjo është një prej mënyrave që i ftojme nxënësit të miqësohen me natyrën, të tregojnë përkujdesje ndaj saj si edhe të njohin teknikat e mbjelljes së luleve. Nxënësit u treguan të gatshëm dhe bashkëpunues për realizimin e këtij aktiviteti, duke përdorur mjetet e nevojshme si fidanë, vazo edhe pleh; mësuan më tepër rreth llojeve të tyre dhe kushtet e favorshme në të cilat lulet duhet të rriten. Bimët i japin mjedisit ku jetojmë ngjyra të larmishme dhe aroma të këndshme, ndërsa ne na japin ndjesinë e të ndjerit mirë, por gjëja më e rëndësishme është që ato na sigurojnë oksigjenin e nevojshëm.

18 mars 2024, Dita Botërore e riciklimit

Nxënësit e klasës së 8-të të shkollës 9-vjeçare " Zenel Qazim Tepshi" në Krujë, janë njohur me simbolikën dhe rëndësinë e kësaj dite botërore. Po ashtu u janë përgjigjur pyetjeve: cilat janë materialet që ne mund të riciklojmë? Gjatë veprimtarive të tyre në shkollë dhe në shtëpi çfarë materialesh kanë përdorur për të ricikluar dhe çfarë produkti kanë krijuar? Bazuar në përgjigjet e tyre, specialistët i shpjeguan se cilat janë ato produkte që mund të riciklojmë ose që duhet të reduktojmë përgjatë përdorimit të tyre në veprimtaritë e përditshme. Përmes videove ilustruese, nxënësit u njohën me "3R-të" si edhe me ndikimin e drejtëpërdrejtë që ato kanë në mjedis. Propozime të shumta lidhur me zgjidhjet e mundshme për problematikat e mbetjeve erdhën nga nxënësit, të cilët duan ta shohin të pastër vendin ku ata jetojnë.

25 mars 2024, Dita Botërore e Ujit

Dita Botërore e Ujit ishte tema me të cilën u njohën nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Perlat" në Durrës. Nxënësit u njohën me burimet ujore të vendit tonë, si dhe mësuuan për ciklin e ujit dhe format e ndryshme të tij. Uji ka vlerë të madhe dhe komplekse për familjet tona, kulturën, shëndetin, arsimin, ekonominë dhe integritetin e mjedisit tonë natyror, ndaj konsumimi i tij duhet të jetë në mënyrë efiçente dhe të mos shpërdorohet pa kriter. Bazuar në këto informacione të marra, nxënësit treguan disa nga aktivitetet e tyre të përditshme, për të cilat kuptuan se duhet të kenë më tepër kujdes mbi sasinë e ujit që konsumojnë. Larja e dhëmbëve dhe e fytyrës, ujitja e kopshtit, larja e biçikletës apo makina e babait etj., janë aktivitete që fëmijët do të tregojnë më tepër kujdes. Kështu duke diskutuar dhe kuptuar rëndësinë e këtij elementi thelbësor për jetën e gjallesave në tokë, arrijmë të sensibilizojmë brezat e ardhshëm, që të jenë më të ndërgjegjshëm për burimet natyrore që natyra na ka falur.

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



4 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Me nxënësit e shkollës së mesme e bashkuar “Shëngjergj”, u zhvillua ora mjedisore në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër. Përgjatë kësaj ore nxënësit u njohën me faunën e Parkut Natyror “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh” ku mësuan më tepër rreth karakteristikave të tyre, dietave ushqimore, habitatet që preferojnë, si edhe kërcënimet që ndikojnë në zhdukjen e tyre. Në përfundim të kësaj ore nxënësit realizuan një poster me vizatimet e kafshëve të tyre të preferuara.

12 mars 2024, “Mbill një lule”

Nxënësit e klasës së parë të Kolegjit “Turgut Ozal” u bënë pjesëmarrës të një aktiviteti argëtues dhe sensibilizues në kuadër të ditës “Mbill një lule”. Me duart e tyre të arta dhe dashurinë për lulet, nën kujdesin dhe me ndihmën e stafit të AdZM-së Tiranë, nxënësit mbollën lule shumëngjyrëshe në mjediset përreth shkollës. Kjo veprimtari praktike jo vetëm i argëton nxënësit, por në të njëjtën kohë i mëson ata që në moshë të vogël për kujdesin që duhet të tregojnë për lulet dhe mjediset përreth tyre. Rezultati këtij aktiviteti ishte realizimi i një lulishteje të vogël, me lloje të ndryshme lulesh.

14 mars 2024, dita e Verës

Nxënësit e klasës parashkollore të shkollës “British School of Tirana” u njohën me disa lloje lulesh dhe mënyrën sesi mund të realizohet mbjellja e tyre. Përmes këtij aktiviteti mësuan sesi mund të përkujdesen për lulet, të duan dhe të kujdesen për natyrë dhe mjedisin që i rrethon. Bashkë me fëmijët mbollën disa vazo me lule, për të zbukuruar mjedisin e klasës ku ata mësojnë.

18 mars 2024, Dita Botërore e riciklimit

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zenel Bastari” u njohën me një proces të thjeshtë të riciklimit të letrës, i cili realizohet shpejt dhe në kushtet e shtëpisë nga kushdo. Nxënësit duhet të grumbullojnë letra të panevojshme dhe t'i copëtojnë ato. Nëpërmjet një mikseri të thjeshtë dhe një sasive të vogël uji, letra do të laget dhe grimcohet plotësisht. Masa e formuar vendoset në një ene të mbushur me ujë dhe më pas kalohet në një sitë në formë katrore. Për të krijuar letrat e ricikluara, masa e formuar duhet të thahet në kushte normale për një ditë dhe mund të përdoret për krijimtari të ndryshme nga fëmijët, në varësi të fantazisë që ata kanë.

21 mars 2024, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Së bashku me shkollën e mesme “Sami Frashëri” në kuadër të kësaj dite mbollëm disa fidanë të llojit Pishë e zezë në zonën e Qafë Murrizit, në Parkun Kombëtar “Mali i Dajtit”. Të tilla nisma shtojnë sipërfaqet e gjelëbruara dhe ulin nivelin e erozionit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



4 mars 2024, Dita Botërore e efijencës energjitike

Specialistët e AdZM-së Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku" në Dorëz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Ruajtja dhe përdorimi i energjisë në mënyrë sa më efijente ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit e kësaj shkolle, në kuadër të datës 4 mars. Nxënësit u njohën më tepër me konceptin e efijencës energjitike dhe pse është e rëndësishme. Ora e hapur mësimore u realizua në formën e bashkëbisedimit me nxënësit, të cilët herë pas here pyesnin ose jepnin mendimin e tyre rreth temës. Mënyra se si nxënësit reagojnë në takimet tona, tregon interesin e tyre për të dëgjuar dhe marrë sa më shumë informacion, duke bërë pyetje dhe ndarë me ne kuriozitetë të ndryshme. Dita Botërore e Efijencës Energjitike ka si qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri dhe jo vetëm; mbi zgjedhjen e burimeve energjitike të rinovueshme dhe miqësore me mjedisin, si edhe përdorimi efijent i saj nga konsumatorët.

11 mars 2024, monumentet e natyrës së bashkisë Gramsh

Promovimi i vlerave mjedisore dhe natyrore të zonave të mbrojtura, është një ndër orët mjedisore më të rëndësishme të zhvilluara nga AdZM-të, me qëllim njohjen dhe promovimin e tyre nga qytetarët. Këtë herë specialistët e AdZM-së Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Gramsh, në afërsi të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit" në kuadër të njohjes së vlerave natyrore të kësaj zone. Nxënësit mësuuan më tepër për florën dhe faunën, monumentet e natyrës dhe destinacionet e shumta, të cilët janë pjesë e bashkisë Gramsh. Të kujdesemi për parkun, bimët dhe kafshët që ndodhen në të, duke garantuar zhvillim dhe rritje normale ishte mesazhi që përcollëm tek nxënësit nëpërmjet kësaj ore.

efijenca energjitike burime energjitike të rinovueshme mbetje plastike

veprime për lumenjtë ripërdorimi i plastikës mounumente natyre

12 mars 2024, "Mbill një lule"

Në kuadër të ditës "Mbill një lule", specialistët e AdZM-së Elbasan në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Dilaver Nezha" Qukës, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik", realizuan një aktivitet për mbjelljen e luleve. Në fillimi nxënësit u njohën me qëllimin e kësaj nisme, më pas njohën mjetet e nevojshme për të realizuar mbjelljet. Me ndihmën e specialistëve të AdZM-së, fëmijët realizuan mbjelljet e luleve shumëngjyrëshe, duke rritur kështu hapësirat e gjelbëruara në shkollën e tyre. Aktivitete të tillë janë mjaft tërheqës, pasi ato nxitin kuriozitetin e nxënësve për të realizuar punë konkrete. Produktet e aktiviteti ishin vazot me bidona plastik, të cilat kur u mbollën gjelbëruan shkollën. Përdorimi i këtyre bidonave ndihmon në të njëjtën kohë edhe në uljen e sasisë së mbetjeve plastike.

13 mars 2024, Dita Botërore për Veprimin e Lumenjve

Në kuadër të "Ditës Botërore për Veprimin e Lumenjve", specialistët e AdZM-së Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Arif Kuka" Karkavec. Si fillim ata u njohën me simbolikën e kësaj dite dhe më pas u informuan rreth problemeve dhe faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në ndotjen dhe shkatërrimin e lumenjve, si dhe masat që duhet të marrin për kujdesin dhe mbrojtjen e tyre. Të kujdesemi për natyrën dhe të mbajmë pastër atë, të mbrojmë lumenjtë dhe të kujdesemi për gjallesat ujore, ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit nëpërmjet kësaj ore mjedisore.

13 mars 2024, Dita Botërore e Riciklimit

Dita Botërore e Riciklimit, ka si qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e riciklimit, në funksion të ruajtjes së burimeve natyrore. Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM-së Elbasan në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isuf Gjura" Kuturman, realizuan një aktivitet mjedisor, përmes një aktiviteti pastrimi. Nxënësit u informuan rreth ndotjes që shkakton plastika dhe llojet e tjera të mbetjeve, të riciklueshme ose jo, si edhe rëndësinë e riciklimit të tyre. Me ndihmën e nxënësve, të cilët u pajisën me mjetet e nevojshme pastruar mjediset rreth zonës së shkollës. Të kujdesemi për mjedisin ku jetojmë, duke e mbajtur pastër atë, ishte edhe mesazhi i cili u përcoll tek fëmijët nëpërmjet këtij aktiviteti.

25 mars 2024, promovimi i vlerave natyrore dhe mjedisore

Specialistët e AdZM-së Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Ahmet Elezi" Stravaj, përgjatë së cilës u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore, me florën dhe faunën e Parkut Kombëtar Natyror "Shebenik". Nxënësit u njohën edhe me monumentet e natyrës dhe destinacionet e shumta, të cilët mund të vizitohen nga të gjithë turistët vendas e të huaj. Mesazhi i përcjellë përmes kësaj ore mjedisore ishte: Të kujdesemi për parkun, duke dhënë kontributin tonë në mbajtjen pastër të mjedisit. Të kujdesemi për banorët e parkut, duke mos i lënduar ata.

27 mars 2024, promovimë vlerat e PKN "Shebenik"

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ramazan Bala" Xibrakë, për njohjen dhe promovimin e vlerave natyrore dhe mjedisore të Parkut Kombëtar Natyror "Shebenik si dhe me florën e faunën. Ora e edukimit mjedisor u realizua në formën e bashkëbisedimit me nxënësit, të cilët herë pas here pyesnin si dhe jepnin mendimin e tyre rreth temës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



1 mars 2024, mbjellja e pishave në PM Pishë Poro-Nartë

AdZM Fier në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Rakip Kryeziu" Fier, përfaqësues nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier dhe me mbështjetjen e Grupit Rinor "Epoka e Re" realizoi një aksion mbjellje, me rreth 300 fidanë të llojit pishë, në Peizazhin e Mbrojtur Pishë Poro-Nartë

3 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Në kuadër të Ditë Botërore të Jetës së Egër, specialistët e AdZM-së Fier zhvilluan një aktivitet mjedisor me nxënës nga shkolla "Ernest Koliqi" Tiranë. Nxënësit fillimisht u njohën me qendrën e vizitorëve dhe më pas arritën të shohin Pelikanin Kaçurrel. Gjithashtu ata bënë një ecje drejt shtegut të Godullës, duke u njohur me botën e egër përgjatë këtij shtegu.

11 mars 2024, praktikë mësimore

Nxënësit e "Albanian Collage" të asistuar nga specialistët e AdZM-së Fier zhvilluan praktikën mësimore pranë qendrës së vizitorëve në Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Marrja e informacioneve mbi florën dhe faunën nëpërmjet hartave, grafikëve, fotove, zërave të shpendëve ishin thelbi i praktikës mësimore në qendrën e vizitorëve.

PM Pishë-Poro
riciklimi

pelikani kaçurrel
ndryshime klimatike

praktikë mësimore

20 mars 2024, “Mbill një lule”

Specialistët e AdZM-së Fier së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gërmenjë”, Divjakë ideuan dhe përgatitën vazo lulesh duke përdorur shishe plastike. Një ndër materialet që ndot më shumë mjedisin është edhe materiali plastik. Më pas në këto vazo u mbollën lule nga nxënësit. Këto aktivitete sensibilizuese shërbejnë për të rritur vullnetin për të ricikluar sa më shumë materiale që të mundemi, duke ulur kështu ndikimin negativ në mjedis.

21 mars 2024, aksion mbjellje

Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë dhe në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe përdorimi i burimeve të tyre janë çelësi për të luftuar ndryshimet klimatike dhe kontribuar në prosperitetin dhe mirëqenien e brezave aktual dhe të ardhshëm. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve AdZM Fier në bashkëpunim me shkollën “Çermë Shkumbin”, Divjakë mbollën 500 fidanë pishë.

27 mars 2024, orë mjedisore për riciklimin

AdZM Fier zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Mizë”, Divjakë. Gjatë kësaj ore mjedisore u bashkëbisedua mbi rëndësinë e riciklimit, çka ndikon në uljen e ndotjes në mjedis dhe ruajtjen e cilësisë së ujit.

29 mars 2024, orë mjedisore me shkollën jopublike “Feniks”

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një aktivitet mjedisorë me nxënës të shkollës jo publike “Feniks”. Nxënësit fillimisht u njohën me qendrën e vizitorëve, florën e faunën e parkut, ndoqën videon e realizuar nga projekti JICA si dhe panë pelikanin Kaçurrel.

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT

03 12 18



3 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Specialistë të AdZM-së Berat zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 8-të, të shkollës 9-vjeçare "Zihni Toska" në kuadër të Ditës Botërore të jetës së egër. Nxënësit mësuuan për jetën e egër, shumëllojshmërinë e specieve që jetojnë në zonat e mbrojtura dhe rëndësinë që ato kanë në zinxhirin ushqimor. Më tej vazhduan me aktivitet krijues, duke krijuar një ese përshkuese për jetën e egër. Ata krijuan edhe një maket të një habitati natyror, sipas fantazisë dhe përfytyrimeve që ata kanë për habitatin e jetës së egër. Më tej vazhduan me aktivitet krijues, duke krijuar një ese përshkuese për jetën e egër. Ata krijuan edhe një maket të një habitati natyror, sipas fantazisë dhe përfytyrimeve që ata kanë për habitatin e jetës së egër.

12 mars 2024, “Mbill një lule”

Në 12 mars, AdZM Berat zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "1 Maji" me nxënësit e klasës së 5-të. Kjo ditë i kushtohet mbjelljes së luleve dhe ardhjes së pranverës. Këtë donim të përcillnim tek nxënësit, përgjatë mbjelljes së luleve me ta. Duke e parë nga afër këtë proces, nxënësit kuptuan mënyrën sesi duhet të mbillen lulet, si përzgjidhet plehu për të ushqyer lulen përgjatë ciklit të saj të jetës. Nxënësit mësuuan gjithashtu se lulet duhet të pozicionohen në varësi të sasisë së rrezatimit që ato kanë të nevojshëm.

18 mars 2024, Dita Botërore e riciklimit

Në kuadër të kësaj dite, AdZM Berat zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 9-të, pranë shkollës 9-vjeçare "5 Maji" në Dimal. Bashkë me ta zhvilluam punë praktike, duke treguar sesi procesi i riciklimit ndikon në mjedis dhe në shëndetin tonë. Nxënësit ripërdorën sende të padobishme, duke i kthyer ato në sende funksionale dhe të dobishme. Një bidon plastik u shndërrua në një vazo për mbjellje farash apo një kanaçe alumini u shndërrua në mbajtësen e lapsave.

shumëllojshmëri speciesh

zinxhir ushqimor

ese përshkuese

maket

habitat natyror

lule dekoruese

sasi rrezatimi

punë praktike



“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



kursimi i energjisë

cikli i jetës

mushkëri e gjelbër

pishë e zezë

mjedis i qëndrueshëm

04	08	11	12	12	13	14	18	21	21	21	27	29
----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

4 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ismail Gjata” në Cangonj, përgjatë datës 4 mars zhvilluan një sërë aktivitetesh në natyrën e bukur të parkut, të organizuara nga specialistët e AdZM-së. Nxënësit ndanë mes tyre kuriozitete për faunën e egër. Disa fole prej druri u vendosën për zogjtë në zona të ndryshme të parkut, duke përcjellë tek njëri-tjetri mesazhe dhe dashurinë për mbrojtjen e kafshëve të egra. Për të përmbyllur aktivitetin e Ditës Botërore të Jetës së Egër zhvilluam një aksion pastrimi në park, duke mbledhur mbetjet urbane.

8 mars 2024, urojmë përmes kartolinave

Në kuadër të ditës së gruas, nxënësit e klasës së tretë të shkollës “Sevasti Qirjazi” Korçë krijuan kartolina urimi si edhe mbollën së bashku me ekspertët disa fidanë lloji gështenjë tek lulishtja para shkollës. Përmes këtij aktiviteti nxënësit uruan të gjitha gratë si edhe shtuan një kontribut më shumë në gjelbërimin e qytetit.

11 mars 2024, orë mjedisore

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Korçë së bashku me nxënësit e klasës së 7-të të shkollës “Kozma Basho” zhvilluan një orë mjedisore. U zhvillua një prezantim me informacione dhe kuriozitete rreth ndotjes së mjedisit dhe detyrat që duhet të bëjë secili prej nesh për ta mbrojtur atë. Mesazhi i përcjellë tek nxënësit ishte “mbrojmë mjedisin dhe çdo gjë që nëna natyrë na ka falur”.

12 mars 2024, "Mbill një lule"

Nxënësit e klasës së 9-të u bënë pjesë e aktivitetit për sensibilizimin mbi ruajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara. Ata realizuan mbjellje të farave të ndryshme në vazo dhe i vendosën në mjediset e shkollës "Mësonjëtorja e Parë Shqipe" në Korçë. Nxënësit janë orientuar me detyrat e ruajtjes dhe përkujdesjes që ata duhet të tregojnë ndaj farave të mbjellura, në mënyrë të atillë që të shohin rezultate pozitive dhe farat të lulëzojnë me sukses.

12 mars 2024, dita mbill një lule

AdZM Korçë së bashku me organizatën Eco Albania dhe nxënësit e klasave të 5-6-ta të shkollës "Haki Mborja" në fshatin Mborje janë kujdesur për zbukurimin e shkollës, duke mbjellë fara lulesh dhe luleshtrydhe dhe pastruar në të njëjtën kohë mjediset e saj.

13 mars 2024, natyra pranë nesh

Bashkë me vitet e treta në shkollën e mesme "Pustec" krijuam herbariume me bimë të cilat gjenden në Parkun Kombëtar të Prespës. Po ashtu me bimët e këtij parku krijuam terrarium dhe eksoistemin e nevojshëm brenda disa vazove prej qelqi, të cilat më pas u vendosën në klasë. Përmes kësaj nisme përçuam tek nxënësit rëndësinë ekologjike të bimëve të Parkut të Prespës dhe format e ruajtjes.

14 mars 2024, Dita Botërore e veprimtimit për lumenjtë

Nxënësit e shkollës "Abdulla Progri" së bashku me specialistët e AdZM-së Korçë, të pajisur me doreza dhe qese plastike, zhvilluan një aksion pastrimi përgjatë lumit Devoll në Progër. Në përfundim të këtij aksioni u realizua mbjellje fidanësh të llojit gështenjë në zonat me më pak bimësi përgjatë këtij lumi.

21 Mars 2024, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Është zhvilluar një orë mjedisore si edhe një aksion mbjellje me nxënësit e klasave të 8-ta në shkollën "Ptoleme Xhuvani", Memëlisht, Pogradec. Ekspertët tanë kanë shpjeguar rëndësinë që pyjet kanë për shëndetin tonë, duke ndërgjegjësuar dhe më tej duke reflektuar për të mos prerë dhe as dëmtuar pasurinë kombëtare të pyjeve. Më pas janë mbjellë 27 fidanë të llojit Pishë e zezë.

18 mars 2024, Dita Botërore e riciklimit

"Të riciklojmë e jo të shpërdorjmë" ishte mesazhi i përcjellë tek fëmijët e qendrës "Qyteza e Fëmijëve" në Korçë. Nën udhëzimet e specialistëve të AdZM-së Korçë, duke përdorur shishe plastike, gërsërë, penela, spango, kunja etj., ata krijuan objekte të ndryshme si fole për zogjtë, arkë kursimesh, shishe dekorative, mbajtëse lulesh etj. Fëmijët mësuam se nëpërmjet procesit të riciklimit dhe përdorimit në ndikojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së mbetjeve në landfill-e si dhe në ruajtjen e burimeve natyrore, të cilat do të shfrytëzoheshin në rast se do të duhej të krijonim një produkt të ri.

21 Mars 2024, një pemë sot – një jetë nesër

Pranë shkollës "Papa Kristo Negovani" në Ersekë zhvilluam një orë mjedisore për Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve. Përmes krijimeve të posterave, nxënësit shprehën mesazhe të ndryshme për mbrojtjen e pyjeve. Mesazhet janë edhe më të qartë e të pranueshëm nga të gjithë, kur ata vijnë përmes ngjyrave dhe krijimeve të nxënësve.

21 mars 2024, me nxënësit e shkollës "Abdulla Progri"

Shkolla "Abdulla Progri" në Progër ishte një tjetër shkollë ku specialistët tanë informuan nxënësit e klasës së 7-të, mbi pyjet tona, rëndësinë e tyre dhe kujdesin e komunitetit. Mesazhi që përcollëm tek nxënësit ishte: Ruani pyjet, thuaj jo prerjes së paligjshme.

27 mars 2024, të kujdesemi për natyrën

Për nxënësit e klasës së 4-ët të shkollës "Sotir Gurra" në Korçë ofruam disa këshilla përgjatë orës mjedisore, të zhvilluar më datë 27 mars. Përmes këshillave ne jo vetëm informojmë nxënësit për të mbrojtur edhe me shumë mjedisin, por në të njëjtën kohë mbjellim edhe fidanë bashkë me ta.

29 mars 2024, me nxënësit mbollëm disa pemë në kodrat e qytetit

Është zhvilluar një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 3-të, pranë shkollës "Sevasti Qirjazi" në Korçë, ku kemi dhënë këshilla se si duhet të mbrojmë mjedisin dhe kemi mbjellë disa fidanë në kodrat e qytetit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



13 mars 2024, aksion mbjellje

AdZM Vlorë në bashkëpunim me bashkinë Vlorë dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” Bishan, përgjatë datës 13 mars realizuan një aksion mbjellje fidanësh përgjatë Lumit Vjosa. Që nga shpallja e Parkut Kombëtar “Lumi Vjosa”, fushatat e mbjelljes dhe pastrimit në këtë park kanë qënë të shumta. AdZM-ja e Vlorës së bashku me dashamirësit e natyrës kanë qënë gjithmonë në gadishmëri të kontribuojnë në ruajtjen e parkut dhe natyrës.



aksion mbjellje Parku Kombëtarë “Lumi Vjosa”

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



3 mars 2024, Dita Botërore e Jetës së Egër

E kujtuam këtë ditë me nxënësit, pranë shkollës “Kamber Bënja”, me qëllimin e edukimit të brezit të ri dhe ndërgjegjësimin e tyre për rolin dhe vlerat e kafshëve dhe bimëve të egra. Nxënësit përmes specialistëve tanë u njohën me llojet më të përhapura dhe ato të rrezikuara, si dhe arsyt që çojnë në zhdukjen e një specie të caktuar. Nxënësit përmes “stuhisë së mendimeve” paraqitën ide dhe mënyra të ndryshme, sesi bota e egër mund të mbrohet. Është detyrë e brezave të ruajnë këtë pasuri, e cila komunikon edhe me krijesat e tjera të planetit tonë.

5 mars 2024, Dita Botërore e Efiçencës Energjitike

Me rastin e Ditës Botërore të Efiçencës së Energjisë, AdZM Gjirokatër në bashkëpunim me shkollën “Urani Rumbo” zhvilloi një orë për edukimin mjedisor, me synim ndërgjegjësimin dhe informimin mbi nevojën dhe rëndësisht e përdorimit të burimeve energjitike të rinovueshme. Klasa e katërt e kësaj shkolle u njoh me termat si: energjia, energjia e rinovueshme dhe e parinovueshme, burimet e energjisë, efektet në mjedis. Me hapa të vegjël dhe të mençur secili nga ne mund ndikojë pozitivisht, përmes formave dhe mjeteve që mundësojnë efiçencën energjitike, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në mirëqënien tonë shëndetësore dhe ruajtjen e mjedisit. Secili mund të përzgjedhë ato pajisje elektrike që konsumojnë më pak elektricitet, të fikë pajisjet që janë të panevojshme dhe rritet përdorimi i burimeve energjitike të rinovueshme, të prodhuara nga panelet diellore. Përmes këtyre forma ne arrijmë të shfrytëzojmë energji të rinovueshme, duke ulur kostot tona financiare dhe në të njëjtën kohë jemi miqësor me mjedisin.

13 mars 2024, Dita e shpalljes së Parkut Kombëtar “Lumi Vjosa”

Me rastin e ditës së shpalljes të lumit Vjosa si Park Kombëtar, në prani të gjimnazistëve të shkollës "Abaz Shehu" treguam rrugëtimin e procesit, i cili deri në realizimin e tij kalon përgjatë hapave, shpesh edhe të vështirë. Shpallja e një zone të mbrojtur, bëhet me qëllimin e përbashkët si të institucioneve ashtu edhe komunitetit të zonës, për të mbrojtur e ruajtur biodiversitetin e një zone të caktuar, si në rastin e lumit Vjosa. Në përfundim realizuam një aksion pastrimi në qytetin e Tepelenës, i cili shërbeu edhe si një formë ndërgjegjësimi për mbajtjen pastër të mjediseve të qytetit dhe zonave të mbrojtura.

21 mars 2024, rëndësia e pyjeve

Kjo ishte tema e orës mjedisore që është zhvilluar më 21 mars, për nxënësit e klasës së 5-të në shkollën "Nonda Bulka" në Përmet.

28 mars 2024, “Kali i Qyqes”

Çiftet folezues të Kalit të Qyqes janë rikthyer në territoret e tyre të folezimit. Për të informuar nxënësit me këtë lloj të rrallë dhe të veçantë shkabe, AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me ZVA dhe stafin pedagogjik të shkollës 9 vjeçare “Avni Rustemi” Libohovë ndanë informacione për këtë specie; habitatet në të cilat këto lloje rriten, me çfarë uyshqehen dhe periudha e folezimit të tyre. Më pas vijuan me një vizitë, së bashku me nxënësit e shkollës në afërsi të territorit të folezimit të Kalit të Qyqes, si dhe kundruam shpendë shtegtarë të zonës. Përmes orëve mjedisore theksojmë rëndësinë e njohjes së llojeve të shpendëve nga fëmijët e çdo grupmoshe, të cilët nëpërmjet edukimit ndërgjegjësohen mbi ruajtjen e habitateve të shpendëve.